

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e Studimit Bachelor në Inxhinieri

Kompjuterike,

Universiteti Privat EPOKA

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm: Prof.As.Elinda Kajo Meçe



Korrik 2017

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e Studimit BSc në Inxhinieri Kompjuterike

Bsc in Computer Engineering

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Epoka
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Arkitektures dhe Inxhinierisë
3	Urdhëri/VKM i licencimit Urdhëri i riorganizimit	VKM Nr. 281, datë 12.03.2008 Urdhër i MASH, Nr. 213, datë 25.05.2012
4	Urdhër i Akreditimit të parë	VKA Nr. 176, datë 30.05.2011 Urdhër Nr. 260, datë 07.06.2011 (*)
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Aktivizimi i programit të studimit	2012-2013
17	Numri total i studentëve për program studimi	59 viti I 59 viti II 40 viti III

*) Sipas Urdhërit të Akreditimit Nr. 260, datë 07.06.2011, ky program studimi është akredituar si Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike, **me kohëzgjatje normale 4 vite**. Eshhtë hera e parë që ky program studimi i nënshtrohet procesit të akreditimit, pas riorganizimit të tij me Urdhër Nr. 213, datë 25.05.2012, si Bsc në Inxhinieri Kompjuterike **me kohëzgjatje normale 3 vite**.

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është kontraktuar nga ASCAL për të kryer procesin e vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bsc në Inxhinieri Kompjuterike. Në raport, GVJ jep mendimin e tij të pavaruar për shkallën e plotësimit të standarteve akademike për këtë program studimi. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin kryen veprimtarinë Universiteti Privat EPOKA, në dosjen e plotë të programit të studimit Bsc në Inxhinieri Kompjuterike, në takimet e zhvilluara si dhe në materialet e shtesë, që u vunë në dispozicion sipas kërkesës së GVJ. Vizita në institucion u zhvillua sipas agendës, në datat 8-9 Qershor 2017.

Sipas VKA Nr 176, datë 30.05.2011, Këshilli i Akreditimit i rekomandon Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, akreditimin pozitiv të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike (4 vite akademike). Mbështetur në VKA nr 176, dt 30.05.2011, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, me Urdhër nr 260, datë 07.06.2011, akrediton programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike me kohëzgjatje normale 4 vite akademike.

Liçensimi është bërë sipas VKM Nr. 281, datë 12.03.2008 dhe leja për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë sipas UMASH Nr. 596, datë 23.12.2008.

Në vitin 2012 Institucioni "EPOKA" ka ndërrmarë provcesin e riorganizimit të këtij program studimi, me qëllim përshtatjen e tij me Sistemin e Bolonjës.

Me VKA Nr 313, datë 16.03.2012, Këshilli i Akreditimit jep vlerësimin përfundimtar pozitiv për riorganizimin e programit të studimit nga Diplomë e Nivelit të Parë në Inxhinieri Kompjuterike (4 vite akademike) në Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike (3 vite akademike). Me urdhër Nr. 213 datë 25.05.2012, Ministri i Arsimit dhe Shkencës Urdhëron miratimin e riorganizimit të programit të studimit të ciklit të parë nga Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) me kohëzgjatje normale 4 vite akademike në "Bachelor" në Inxhinieri Kompjuterike, që realizohen me 180 kredite evropiane dhe me kohëzgjatje 3 vite akademike.

Sipas Urdhërit të Akreditimit Nr. 260, datë 07.06.2011, ky program studimi është akredituar si program Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike, me kohëzgjatje normale 4 vite. Është hera e parë që ky program studimi i nënshtrohet procesit të akreditimit, pas riorganizimit të tij me Urdhër Nr. 213, datë 25.05.2012, si Bsc në Inxhinieri Kompjuterike me kohëzgjatje normale 3 vite.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. As. Elinda Kajo Meçe

Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është bërë nga ASCAL dhe miratimi i përbërjes së tij në Bordin e Akreditimit, me Urdhër nr. 49, datë 07.06.2017. Nga ASCAL mori pjesë specialistja Znj. Renata Qatipi.

Institucioni "Universiteti Epoka" me shkresë Nr. 020/13 Prot, datë 12.07.2017 "Dërgohen komente në lidhje me Draf- Raportet e Vlerësimit të Jashtëm për programet e studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" dhe Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi" ka sjellë në

ASCAL komentet lidhur me Draft RVJ. Eksperti pasi njohu komentet e institucionit, në lidhje me Draft Raportin nuk reflekton ndryshime në Raportin përfundimtar.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

Sipas VKA Nr 176, datë 30.05.2011, Këshilli i Akreditimit i rekomandon:

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Harmonizimi më i mirë i sistemit amerikan të përdorur me atë europian në kuadër të procesit të Bolonjës;
- b) Zgjerimi i kompletimit të bibliotekës me literaturë më të larmishme e me tirazh më të lartë.
- c) Stimulimi më i mirë i punës individuale të studentit gjatë zhvillimit të procesit mësimor duke il dhënë përparësi orëve të vecanta të seminareve, prezantimeve me gojë, eseve të ndryshme, projekteve individuale e në grup etj.
- d) Një profilizim më i qartë i stafit akademik në fusha të caktuara në shërbim të rritjes së nivelit të mësimdhënies.
- e) Të koordinojë më mirë kohëzgjatjen e qëndrimit të profesorëve vizitorë në mënyrë që të mos krijohet mbingarkesë mësimore për studentët.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Sipas RVB plani mësimor i programit të studimit është mbështetur në modelet e universiteve turke dhe amerikane. Mbështetur në dokumentacionin e programit të studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike lëndët janë përcaktuar në ECTS, të ndara sipas formës së mësimdhënies. Bazuar në sistemin evropian 1ECTS = 25 orë përcaktohen orët në auditor dhe në punë të pavarur.
- b) Gjatë vizitës u konstatua se Universiteti Epoka ka një bibliotekë me një numër të konsiderueshme tekstesh për literaturën bazë dhe ndihmëse të shprehur në syllabuse. Biblioteka është e regjistruar në disa burime online, ku aksesohen tekste, publikime dhe artikuj shkencor.Ka një procedurë të pasurimit të vazhdueshëm të saj sipas kërkesave të departamentit.
- c) Mbështetur në dokumentacionin e programit të studimit Bsc në Inxhinieri Kompjuterike si dhe në takimin me studentët, konstatohet se në lëndët e këtij programi studimi zhvillohen laboratore dhe detyra kursi, ku i jepet rëndësi punës individuale dhe asaj në grup të studentit.
- d) Bazuar në CV e stafit akademik dhe në takimin me ta, konstatohet se stafi akademik që mbulon këtë program studimi është i kualifikuar sipas fushës përkatëse.
- e) Sipas listës së stafit akademik të këtij programi studimi dhe takimit me drejtues të Universitetit Epoka, konstatohet se nuk ka profesorë vizitor që mbulojnë ngarkesë mësimore në periudha të shkurtra kohore.

Mendoj se Institucioni ka plotësuar rekomandimet e Këshillit të Akreditimit.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe RVB, programi i studimeve Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike ka të përcaktuar misionin dhe objektivat e tij. Misioni i programit të studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike është në thelb ofrimi i një përgatitje tekniko-shkencore sa më të mirë në mënyrë që inxhinierët e diplomuar në këtë fushë të kenë njohuritë e nevojshme që kërkon tregu i punës lokal dhe ai global. Programi ka si qëllim që studentët që do të diplomohen pasi kanë fituar njohuritë e shkencave bazë të formohen teorikisht dhe teknikisht në fushën e inxhinierisë kompjuterike në mënyrë që të mund të ofrojnë zgjidhje për problemet ndryshme në këtë fushë duke qenë të aftë për të përmirësuar aftësitë e tyre në mënyrë të mëtijshme. Gjatë këtij programi studenti merr njohuri të thelluara mbi sistemet harduerike dhe ato softuerike.

Programi studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike, mbështetur në RVB (ref. faqe 7) dhe dokumentacionin plotësues, ka për qëllim:

- Përgatitjen e studentëve me njohuri të thelluara teorike në shkencat bazë dhe inxhinierinë kompjuterike duke u pajisur dhe me aftësitë e nevojshme teknike;
- Sigurimin e përvojës praktike që do t'u mundësojë studentëve që të shfrytëzojnë dhe të zgjerojnë njohuritë e tyre inxhinierike;
- Nxitjen e pavarësisë, vetë-disiplinimin dhe vetë-sigurinë tek studentët;
- Inkurajimin e punës në grup, dhe zhvillimin e aftësive ndërvepruese dhe komunikuese në mënyrë verbale dhe orale;
- Motivimin e studentëve për të kontribuar në përparimin e shkencës dhe teknologjisë;
- Të mësuarit e të qykuarit në mënyrë kritike dhe objektive si dhe me një sjellje etike në jetën shoqërore dhe profesionale.

Gjatë vizitës u kërkuar të vihet në dispozicion qëllimi dhe objektivat e programit të mëparshëm 4 vjeçar për të bërë krahasimin, sesi kanë ndryshuar ato në riorganizim në sistemin 3 vjeçar bachelor. GVJ mendon se do të ishte më e saktë dhe në përputhje me kohëzgjatjen e studimeve bachelor, përcaktimi si qëllim i përgatitjes së studenteve me njohuri bazë dhe jo të thelluara, sic përshkruhet në dokumentacionin e këtij programi studimi. Rekomandim: Të rishikohen objektivat për t'u përshtatur edhe me mirë me nivelin dhe kohëzgjatjen e studimeve bachelor.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin	

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

e tij.

Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;

Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;

Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;

Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.

Programi i studimit Bsc në Inxhinieri Kompjuterike është plotësisht në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit privat Epoka.

Duke ju referuar dokumentacionit të programit të studimit vërehet një përshkrim i qartë i objektivave formues të programit të studimit.

Programi është projektuar të adresojë nevoja të tregut të punës.

Sipas RVB, ka një studim tregu të bërë nga universitetit Epoka që në fillim të lincensimit të tij. GVJ konstatoi se nuk ka një studim tregu të lidhur direkt me këtë program studimi.

Ky program studimi është hartuar në mënyrë të tillë që të kontribuojë në përgatitjen e specialisteve të cilët do të mbështesin zhvillimet e teknologjisë së informacionit lidhje me kërkesat e tregut të punës duke ju përgjigjur zhvillimit ekonomik të vendit

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;

Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;

Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, rezulton se programi i studimit Bsc në Inxhinieri Kompjuterike realizohet në përputhje me strategjitë e zhvillimit të Universitetit privat Epoka

Bazuar në dokumentacionin e strukturës së planit mësimor, vërehet se programi synon të pajisë studentët me njohuritë bazë të formimit shkencor, edhe pse në dokumentacionin e programit të studimit thuhet „njohuri të thelluara“.

Bazuar në dokumentacionin e strukturës së planit mësimor, vërehet se programi synon formimin e shprehive të veçanta përmes praktikave formuese dhe laboratorike.

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.

Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;

Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:

- mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;
- kërkesat e punëdhënësve;
- një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;
- numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.

Programi i Studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike synon të kontribuojnë në krijimin e një brezi të ri inxhinierësh, të formuar sipas nevojave të kohës, në përputhje me nevojat e tregut të punës kombëtar.

Në RVB deklarohet se ka një studim tregu të bërë nga universitetit Epoka që në fillim të lincensimit të tij.

GVJ konstatoi se nuk ka një studim tregu të lidhur direkt me këtë program studimi. GVJ ju vu në



	dispozicion një studim tregu të realizuar se fundmi për një program të ngjashëm studimi.
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare; Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike ofrohet në pajtim me interesat kombëtare. Edhe pse ruajtja e vlerave kombëtare nuk mund të identifikohet drejtpërdrejt mund të thuhet se programi i studimit synon të ndihmojë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare, përmes punimeve shkencore të stafit dhe projekteve të studentëve të tij.
Konkluzione të GVJ:	
Programi i studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike është plotësisht në përputhje me qëllimet, misionin dhe strategjinë e zhvillimit të Universitetit Privat Epoka. Programi i studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike synon plotësimin e kërkesave të tregut të punës për specialistë në fushën e Inxhinierisë Kompjuterike. Universiteti privat Epoka ka njohuri të konsiderueshme në lidhje me tregun e punës, por mungon një studim tregu i detajuar për programin e studimit që po vlerësohet. Rekomandim: Të rishikohen objektivat për t'u përshtatur edhe me mirë me nivelin dhe kohëzgjatjen e studimeve bachelor.	

2. Struktura akademike e Fakultetit i Arkitekturës dhe Inxhinierisë (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Sipas RVB, programi i Studimit **Bsc në Inxhinieri Kompjuterike**, ofrohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, i cili përbëhet nga:

- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit
- Departamenti i Arkitekturës
- **Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike**

Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike organizojnë dhe drejtojnë mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në programin e studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike.

Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, (ref. RVB, faqe 9) ofron programe universitare dhe pasuniversitare në Inxhinieri Kompjuterike dhe Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital. Programi universitar është i bazuar në sistemin trevjecar dhe studentët marrin



diplomën Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike si dhe Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital.

Ngarkesa mësimore në kredite për këtë program studimi është 180 ECTS ose 120 kredite amerikane të Universitetit "Epoka".

Numri i personelit akademik me kohë të plotë është 12 dhe numri i personelit akademik me kohë të pjesshme është 4, të cilët janë përgjegjës për mbulimin e ngarkesës mësimore të programit të studimit. Gjithashtu janë edhe katër personel ndihmës akademik, me master dhe bachelor, që shërbejnë si asistentë në laboratorët e kompjuterit dhe laboratorët e elektronikës.

Bazuar në RVB, dokumentacionin e vënë në dispozicion, takimet e realizuara gjatë vizitës, si dhe në informacionin e publikuar në faqen web zyrtare, GVJ mendon se univesiteti privat Epoka, Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi, janë të konsoliduar nga ana organizative dhe funksionale.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Sipas RVB, struktura përgjegjëse për programin e studimit Bsc Inxhinieri Kompjuterike është Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë dhe Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike.

Për realizimin e ngarkesës mësimore është angazhuar personeli akademik me kohë të plotë si dhe personeli akademik i ftuar me kontratë.

Në RVB janë paraqitur tabelat vetëm me të dhënat e personelit akademik për vitin akademik 2016-2017. Për vitin akademik 2016-2017, numri i personelit akademik me kohë të plotë është 12 dhe numri i personelit akademik me kohë të pjesshme është 4, të cilët janë përgjegjës për mbulimin e ngarkesës mësimore të programit të studimit. Gjithashtu janë edhe katër personel ndihmës akademik, me master dhe bachelor, që shërbejnë si asistentë në laboratorët e kompjuterit dhe laboratorët e elektronikës.

Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në kontratën e punës dhe në rregullore. Kontratat janë tre forma: për stafin efektiv janë njëvjeçare dhe tre vjeçare dhe pa afat, ndërsa për personelin akademik me kontratë këto kontrata janë semestrale. Në të përshkruhen në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrat që ka secili staf për mbarëvajtjen e punëve. Këto të drejta janë në përputhje me statutin dhe rregulloret e universitetit. Kontratat qëndrojnë tek zyra e financës. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për mbajtjen e dosjeve të personelit. Në zyrën e burimeve njerëzore gjatë takimit u kontrolluan në mënyrë rastësore 7 dosje të personelit akademik me kohë të plotë dhe të personeli akademik me kohë të pjesshme. Nga dosjet personelit akademik me kohë të pjesshme, vetëm njëra prej tyre nuk



përbante lejen nga institucioni ku punon me kohë të plotë personeli akademik, të tjerat përmbanin të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Takimi me stafin akademik u realizua sipas programit datë 8 qershor 2017. Në këtë takim ishin të pranishëm 9 pedagogë, vetëm personeli akademik me kohë të plotë. Takimi i organizua mbi bazën e pyetjeve dhe diskutimeve rreth metodave të mësimdhënies, mënyrës së vlerësimit të studentëve, mënyrës së rekrutimit të tyre në Universitetin privat Epoka si dhe ngarkesën javore dhe vjetore të tyre. U evidentua një ngarkesë mësimore javore e konsiderueshme e stafit akademik të brendshëm. Rekomandohet të bëhen përpjekje në reduktimin e kësaj ngarkese mësimore, duke rritur numrin e stafit akademik me kohë të plotë. Të dhëna për Personelin akademik, jepet në Tabela 1, Tabela 3 dhe raporti PAE/PAK jepet në Tabela 4 në aneks.

Referuar këtyre të dhënave GVJ mendon se programi i studimit Bsc. në Inxhinieri Kompjuterike ka stafin akademik të nevojshëm në sasi dhe cilësi, por rekomandohet të bëhen përpjekje në reduktimin e ngarkesës mësimore javore të stafit akademik me kohë të plotë, duke rritur numrin e tij.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Universiteti privat Epoka ndjek procedura ligjore të parashikuara dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren.</p> <p>Sipas RVB, personeli akademik me kohë të plotë mbulon 77-80% të ngarkesës mësimore. Kjo përqindje tregon raportin e kredive totale ECTS të lëndëve, ose raportin e orëve të leksioneve.</p> <p>Universiteti "Epoka" zotëron procedura ligjore transparente të rekrutimit të stafit akademik efektiv dhe me kontratë. Informacioni është i publikuar në faqën zyretare http://hr.epoka.edu.al/;</p>
Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor, ose titullin akademik "Docent,."</p>	<p>Universiteti privat Epoka disponon një bazë të dhënash të për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Gjithshtu disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrative. Te dhenat janë publike edhe në faqen web të Universitetit Epoka http://cen.epoka.edu.al/;</p> <p>Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të publikuara në web</p>

	<p>http://hr.epoka.edu.al/;</p> <p>Titullarët të lëndëve/moduleve për programet e studimeve në disa raste nuk janë personel akademik me gradën shkencore “Doktor”.</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Universiteti privat Epoka ka angazhuar personel ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve. Tregohet një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve Bsc. Inxhinieri Kompjuterike.</p> <p>Studentët e programit të studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike e kryejnë praktikën mësimore mbas vitit të dytë të studimeve në kompani dhe institucione të ndryshme.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Universiteti privat Epoka është e angazhuar për kualifikimin e mëtejshëm profesional të stafit akademik. Nga të dhënat e paraqitura stafi akademik që ende nuk ka gradë shkencore është student doktorature ose në përfundim të dizertacionit.</p> <p>Universiteti privat Epoka disponon të dhëna të plota për programet e studimit të cilat jepen nëpërmjet faqes së internetit epoka.edu.al</p> <p>I gjithë informacioni rreth lëndëve të ofruara dhe rreth programit në përgjithësi jepet në “Guida Studentore” që u jepen studentëve në version të printuar në fillim të çdo viti, jepet në faqet eis.epoka.edu.al dhe cen.epoka.edu.al.</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p> <p>Universiteti privat Epoka ndjek procedura ligjore të parashikuara dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik. Ka një bazë të dhënash për personelin akademik me kohë të plotë dhe me kontratë. Për realizimin e programit të studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike angazhohet një personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrative. Universiteti privat Epoka është e angazhuar për kualifikimin e mëtejshëm profesional të stafit akademik.</p> <p>Stafi akademik me kohë të plotë rezulton me një mbingakesë mësimore javore të konsiderueshme, ndaj rekomandohet reduktimi i kësaj ngarkese, duke rritur numrin e stafit akademik.</p>	

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në RVB, Universiteti Privat Epoka është i vendosur në autostradën Tiranë-Rinas në km e 12-të. Kampusi qendror i Rinasit shtrihet në një sipërfaqe totale prej 67.000 m². Viti akademik 2016 -2017 po zhvillohet rregullisht në ambientet e 2 godinave të përfunduara me një sipërfaqe totale prej 14352 m². Godina E ka një infrastrukturë moderne dhe një sistem qendror ngrohje-ftohje. Klasat janë të pajisura me videoprojektorë dhe me tabela inteligjente të cilat bëjnë të mundur zhvillimin normal të procesit mësimor. Përveç klasave të mësimi, në godinën A “Objekti Social Kulturor” ka dhe ambiente çlodhëse për studentët si mensë, kafeteri, bibliotekë, sallë interneti, mjedise për Këshillin Studentor dhe klubet studentore. Universiteti Epoka ka 1 sallë konferencash në kampusin qendror në Rinas me sipërfaqe prej 128 m² dhe kapacitet prej 99 personash. Salla e konferencave është përdorur më shumë për aktivitetet sociale dhe kulturore dhe konferencat e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Salla është e pajisur me sistem qendror ngrohje-ftohje, me videoprojektor, me sistem zëri dhe me dy kabina për përkthim simultan. Biblioteka e Universitetit Epoka funksionon si pjesë përbërëse e institucionit, ajo gjendet në katin e parë të godinës A në kampusin e universitetit dhe ka një sipërfaqe prej 400 metra katror. Biblioteka ka një fond të pasur me libra në degët përkatëse me rreth 10000 libra (ref RVB). Librat që ndodhen në bibliotekë janë të inventarizuar dhe të ndarë sipas fushave dhe tematikës. Librat janë zgjedhur në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve dhe stafit akademik e administrativ.

Biblioteka ka akses në disa burime online si JSTOR etj. Universiteti Epoka ka vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik disa shërbime online. Të dhënat për mjediset në dispozicion të programit të studimit në vlerësim janë në aneks.

Mbështetur në të dhënat mbi mjediset, në aneks Tabela 7, Tabela 8, Tabela 9, Tabela 10 dhe në vizitën e bërë në këto ambiente, GVJ mendon se Universiteti Epoka ka të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e këtij program studimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;	Në bibliotekën e Universitetit “Epoka”, një numër të konsiderueshëm tekstesh bazë dhe literature ndihmëse.
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;	Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;
Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;	Biblioteka ka një fond të pasur me libra në degët përkatëse me rreth 10000 libra (ref RVB). Librat që ndodhen në bibliotekë janë të inventarizuar dhe të ndarë sipas fushave dhe tematikës.
Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të	

detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;

Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.

Librat janë zgjedhur në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve dhe stafit akademik e administrativ.

Biblioteka ka akses në disa burime online si JSTOR etj

Oraret e punës të bibliotekës janë të shpallura në mjediset e institucionit. Ato janë edhe në hyrje të bibliotekës, e cila është e hapur për studentët nga e hëna deri të premten nga ora 8:30 deri në 17:30 dhe të shtunën nga ora 9:00 deri në 13:00

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.

Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.

Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.

Universiteti Epoka dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme hapësira, si: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve.

Klasat dhe auditorët janë të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për një proces mësimor sa më efektiv, si system kondicionimi, kompjuter, projektor, tabelë interaktive, internet.

Laboratorët e kompjuterave janë të pajisur me software të cilat vihen në dispozicion të studenteve për realizimin e punëve laboratorike.

Në të gjithë kompjuterat në laboratorët e kompjuterave, dhe në kompjuterat në bibliotekë janë instaluar programet e nevojshme.

Universiteti Epoka, ka marreveshje bashkëpunimi me institucione dhe subjekte të tjera, për zhvillimin e praktikave profesionale.

Konkluzione të GVJ:

Universiteti Epoka zotëron hapësira të mjaftueshme, salla leksioni, seminaresh dhe laboratoresh, të pajisura me elementët e duhur, duke ofroruar infrastukturën e nevojshme në dispozicion të procesit mësimor. Laboratorët janë të pajisur me kompjutera, pajisje elektronike dhe softuare të nevojshme për realizimin e punëve të laboratorit, të përcaktuar në programin mësimor. Biblioteka ka një fond me një numër të konsiderueshëm tekstesh për literaturën bazë dhe ndihmëse të shprehur në syllabuse. Biblioteka është e regjistruar në disa burime online, ku aksesohen publikime dhe artikuj shkencor. Universiteti Epoka i vë në dispozicion edhe ambiente të tjera pune për studentët për të zhvilluar temat e diplomave.

GVJ mendon se Universiteti Epoka ka të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e këtij program studimi.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Sipas RVB dhe të dhënave të paraqitura në tabelën “Burimet Financiare”, pjesa më e madhe e të ardhurave nga pagesat e studentëve shkon për shpenzime në lidhje me tarifën për dhe gjatë shkollimit. Nga shqyrtimi financiar i kryer nga vetë Universiteti Epoka rezultoi se të ardhurat mesatare për student për vitin akademik 2015-2016 janë 1.846 euro, ndërsa shpenzimet mesatare për student për vitin akademik 2015-2016 janë 1.342 euro. Të ardhurat dhe financimet në tre vitet e fundit janë paraqitur në aneks, Tabela 11. Të dhënat financiare të Turgut Ozal Education sh.a kontrollohen në mënyrë të rregullt nga institucionet kompetente shtetërore. Përveç kësaj, çdo vit institucioni auditohet nga kompani audituese të jashtme. Raportet e këtyre auditëve janë të disponueshme në Zyrën e Financës.

Duke iu referuar raportit financiar zyrtar të Shoqërisë Turgut Ozal Education sh. a., kompania ka një bilanc vjetor pozitiv, i cili garanton ecurinë e Universitetit Epoka dhe vazhdim të aktivitetit akademik

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Shoqëria Turgut Ozal Education sh. a. bën çdo vit një auditim të jashtëm, për sa i përket situatës financiare dhe raporti ruhet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shoqërisë Turgut Ozal Education sh. a.</p> <p>Në raportin e auditit paraqiten të gjitha të dhënat mbi shpenzimet dhe të ardhurat që ka Shoqëria Turgut Ozal Education sh. a.. Brenda raportit janë të specifikuar të gjitha zërat në lidhje me të ardhurat si: grantet, taksat studentore etj. dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ofron në mënyrë direkte apo indirekte</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifën e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare</p>	<p>Raporti financiar hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shoqërisë Turgut Ozal Education sh. a. çdo vit dhe arkivohet pranë kësaj drejtorie.</p> <p>Raportet financiare të tre viteve të kaluara akademike janë të disponueshme në Zyrën e Financës së Universitetit “Epoka” dhe në Zyrën e Financës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të</p>



dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Shoqërisë Turgut Ozal Education sh.a, pjesë e së cilës është edhe Universiteti “Epoka”. Sipas RVB, referuar raportit financiar zyrtar të Shoqërisë Turgut Ozal Education sh. a., kompania ka një bilanc vjetor pozitiv, i cili garanton ecurinë e Universitetit “Epoka”.
<p><u>Konkluzione të GVJ:</u></p> <p>Shoqëria Turgut Ozal Education sh. a. ku bën pjesë Universiteti privat Epoka vlerëson dhe dokumenton gjendjen financiare. Financimi dhe të ardhurat për departamentin përgjegjës të këtij programi studimi është pjesë e informacionit dhe të dhënave të Universitetit Epoka.</p> <p>Duke iu referuar raportit financiar zyrtar të Shoqërisë Turgut Ozal Education sh. a., kompania ka një bilanc vjetor pozitiv, i cili garanton ecurinë e Universitetit Epoka dhe vazhdim të aktivitetit akademik</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sipas RVB, Universiteti Epoka ka ngritur Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Ngritja dhe funksionimi i këtij sistemi rregullohet nëpërmjet Udhëzimit “Për vlerësimin akademik dhe përmirësimin e cilësisë në Universitetin Epoka”. Këshilli i Vlerësimit Akademik dhe Zhvillimit të Cilësisë (KVAZHC) përbën njësinë qendrore të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në Universitetin “Epoka”. Numri i anëtarëve të KVAZHC-së përcaktohet nga Senati i Universitetit. Anëtarët e KVAZHC-së zgjidhen nga Senati për një periudhë dyvjeçare. Kryetari i KVAZHC-së zgjidhet nga Senati ndërmjet anëtarëve të Këshillit.

Në përfundim të çdo semestri akademik, të gjithë studentët e Universitetit Epoka plotësojnë nëpërmjet sistemit elektronik pyetësorët në lidhje me vlerësimin e pedagogut për çdo lëndë. Përmbajtja e pyetësorëve është standarde dhe konsiston në vlerësimin nga ana e studentit të 14 përbërësve me një interval nga 1 (vlerësimi më i ulët) deri në 4 (vlerësimi më i lartë). Cdo student është i detyruar të plotësojë pyetësorin në mënyrë që të ketë mundësi të shohë në sistemin elektronik notën përfundimtare të marrë në lëndën përkatëse.

Me përfundimin e plotësimit të pyetësorëve, sistemi elektronik nxjerr mesataren e vlerësimit për çdo pedagog lënde me një shifër të përgjithshme si dhe shifër për çdo përbërës të pyetësorit, duke treguar renditjen e pedagogut të asaj lënde në rang departamenti dhe fakulteti. Rezultatet e pyetësorëve i përcillen Rektoratit nga Sekretaria Mësimore. Rektori, pasi shqyrton rezultatet e pyetësorëve, ia përcjell ato KVAZHC-së, i cili kryen analizimin e të dhënave për çdo lëndë dhe pedagog dhe del me rekomandimet përkatëse për Rektoren.

Nëpërmjet mbledhjeve të Senatit, Rektori siguron që rekomandimet e KVAZHC-së në lidhje me përmirësimin e procesit të mësimdhënies të zbatohen në nivel Fakulteti dhe Departamenti.



Në përfundim të çdo semestri akademik, KVAZHC kryen një analizë sasiore dhe cilësore të rezultateve të studentëve dhe del me rekomandimet përkatëse, me një theks të veçantë në evidentimin e problematikave dhe të fushave që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Universiteti Epoka harton në përfundim të çdo viti akademik një Raport Vetëvlerësimi, të cilin ia paraqet Këshillit të Lartë të Universitetit. Universiteti Epoka zhvillon dhe një process në kuadër të certifikimit ISO për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë.

Të dhënat për anëtarët e NJSBC janë paraqitur në Tabela 12 në Aneks.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); Dëgjime në auditor; Vlerësimi me nota/pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Etj. 	<p>Universiteti Epoka ka institucionalizuar sigurimin e brendshëm të cilësisë, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Universiteti Epoka harton një raport vetëvlerësimi, dhe publikon rezultatet e vlerësimit në faqen zyrtare.</p> <p>Universiteti Epoka përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta për kryerjen e vlerësimit.</p> <p>Studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogëve dhe në atë të zbatimit të programeve të studimeve. Në fund të çdo semestri akademik, nëpërmjet anketimeve të përgatitura, studentët japin mendimin e tyre në lidhje me pedagogun dhe brendinë e lëndës.</p>
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË	
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që</p>	<p>Universiteti Epoka ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programit të studimit.</p> <p>Universiteti Epoka përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Universiteti Epoka harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të</p>



<p>ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron.</p> <p>Universiteti Epoka përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron.</p> <p>Universiteti Epoka harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>
<p>Konkluzione të GVJ:</p> <p>Universiteti privat Epoka garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve. Është ngritur sistemi i sigurimit të brendshëm të cilësisë, i cili ka përgatitur një sërë instrumentesh që përdoren në funksion të sigurimit të cilësisë. Vlerësimi për procesin mësimor pasqyrohen në raporte vetëvlerësimi.</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij


Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, programi i studimeve Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike ka të përcaktuar misionin dhe objektivat e tij (ref.RVB faqe 45).

Organizimi i vitit akademik bëhet në bazë të kalendarit akademik, të publikuar në fillim të vitit akademik në faqën web zyrtare të Universitetit Epoka. Në programin e studimit Bsc. Inxhinieri Kompjuterike, sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student është 60 kredite dhe në përfundim 180 kredite. Planin mësimor të programit të studimit (Tabela 13) paraqet të dhënat për lëndë/modulet, të ndara në vite akademik dhe në semestra, Informacioni për lëndët përmban, numrin e krediteve, semestrin kur zhvillohet lënda, ngarkesën javore për studentin, orët në auditor dhe punë të pavarur, sipas formave të mësimdhënies që ka lënda, leksione, seminare, laborator, praktikë.

Në RVB shkruhet se për leksionet, përcaktimi i krediteve (ECTS) bëhet duke mbledhur orët në auditor dhe orët e punës së pavarur të studentëve dhe shuma e orëve pjesëtohet me 25. (1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit). Për seminare, përcaktimi i krediteve (ECTS) bëhet duke mbledhur orët në auditor dhe orët e punës së pavarur të studentëve dhe



shuma e orëve pjesëtohet me 25. (1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit). Gjithashtu sipas RVB, mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 1328 orë në auditor dhe 1830 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 256 orë në auditor dhe 325 orë punë e pavarur e studentit
- Për Labororet 336 orë në auditor dhe 425 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 2 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit

Ngarkesa totale në auditor paraqitet në Aneks, Tabela 18.

Nga plani mësimor vihet re se nuk ka një rregull të ndarjes së 1 ECTS (25 orë) sa orë janë në auditor dhe sa janë punë e pavaruar. Në lëndët:

- Rrjetet Kompjuterike 4.5 kredite leksion janë 48 orë në auditor dhe 64 orë punë e pavarur,
- Algjebër Lineare 5 kredite leksion janë po 48 orë në auditor dhe 77 orë punë e pavarur,
- Programim i Orientuar në Objekte 4.2 kredite leksion janë po 48 në auditor 57 orë punë e pavarur.

Nuk gjendet një ndarje e njëjtë e 25 orëve të një krediti. Gjatë vizitës është kërkuar nëse ka një rregull të brendshëm të universitetit për ndarjen e krediteve po nuk është venë në dispozicion asnjë dokument shtesë që tregon se ka një rregull në lidhje me këtë ndarje. Rekomandohet përcaktimi i një rregulli ndarje të orëve të një krediti sipas formës së mësimdhënies.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe në takimet gjatë vizitës u evidentuan ndryshime në planin mësimor (Tabela 13). Në aneks janë paraqitur ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programin e licensuar. (Tabela 15). Këto ndryshime nuk e kalojnë masën prej 20 % të krediteve të programit të studimit, nuk ndryshojnë përcaktimin e lëndëve të planit mësimor sipas veprimtarive formuese (Tabela 14).

Syllabuset e cdo lëndë të vëna në dispozicion përbajnë: emërtimin e lëndës, përshkrimin objektivat mësimore, programin mësimor gjatë gjithë semestrit, librat dhe materialet mësimore të nevojshme, por vihet re se në disa raste mungon elementi i njohurive paraprake që duhet të ketë studenti për të ndjekur lëndën, apo që titullari i lëndës nuk ka të paktën gradën "Doktor".

Në format e kontrollit të njohurive përdoren: ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive, plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit), testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar. Këto forma kanë një ndarje në % të paraqitur në Tabela 19.

Si përfundim GVJ mendon se Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike jep informacionin e nevojshëm për studentët dhe të interesuarit e tjerë për programin e studimit, si dhe disponon dokumentacionin e nevojshëm të plotë për informim si kohëzgjatjen dhe ngarkesën e programit të studimit, planin mësimor, syllabuset e lëndëve, etj Rekomandohet : një ndarje në bazë të një rregulli të një krediti (25 orë) në orë në auditor dhe orë punë të pavarur sipas formave të mësimdhënies; caktimi si titullar lënde i stafit akademik me të paktën gradën Doctor, në ato raste kur nuk respektohet; plotësimi i parakushteve në syllabuset e lëndëve, aty ku mungojnë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Universiteti “Epoka” ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredi ECTS, dhe 30 ECTS në semestër;</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Universiteti “Epoka” dhe Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, si njësi e saj kryesore, jep në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve Bachelor që ofron. Informacioni mund të merret edhe nga sekretaria mësimore dhe sekretaria e Departamentit. Informacioni gjendet në faqen web me adrese www.eis.epoka.edu.al dhe www.cen.epoka.edu.al</p> <p>Informacione e publikuara janë:</p> <p>Kurrikula e plotë e programit mesimor që përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emertimin e lëndës - Numrin e ECTS-ve - Ndarjen e orëve mes leksioneve, seminareve dhe laboratoreve - Silabuset për cdo lende që perbajne: - Emertimin e lëndës - Përshkrimin - Objektivat mesimore - Programin mesimore gjatë gjithë semestrit - Librat dhe materialet mësimore të nevojshme <p>Mungojne parakushtet per te ndjekur lenden ne disa prej tyre</p>
Konkluzionet e GVJ:	
<p>Universiteti Privat Epoka ofron programe të akredituara të studimeve. Në programin e studimit Bsc. Inxhinieri Kopjuterike, sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student është 60 kredite dhe në përfundim 180 kredite.</p>	

I gjithë informacioni i nevojshëm për përmbajtjen e programit të studimit Bsc. Inxhinieri Kopjuterike është publikuar në web. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike jep informacionin e nevojshëm për studentët dhe të interesuarit e tjerë për programin e studimit, si dhe disponon dokumentacionin e nevojshëm të plotë për informim si kohëzgjatjen dhe ngarkesën e programit të studimit, planin mësimor, syllabuset e lëndëve, etj

Rekomendohet : një ndarje në bazë të një rregulli të një krediti (25 orë) në orë në auditor dhe orë punë të pavarur sipas formave të mësimdhënies për të gjitha lëndët; caktimi si titullar lënde i stafit akademik me të paktën gradën Doktor, në ato raste kur nuk respektohet; plotësimi i parakushteve në syllabuset e lëndëve, aty ku mungojnë.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia është në dy forma teorike dhe praktike, ku leksionet janë në formën teorike dhe seminarët e lëndëve, orët laboratorike dhe praktike janë forma praktike.

Programi i Inxhinierisë Kompjuterike		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	1328
b.	Seminare	256
c.	Ushtrime	0
d.	Laboratore	336
e.	Praktikë lëndore	0
f.	Praktikë profesionale	0
g.	Etj	0
	Në total	1920

Referuar orëve totale në auditor sipas formave të mësimdhënies, rezulton se peshën më të madhe e kanë leksionet, mendoj se do të ishte mirë të rishikohej ky raport në favor të seminarëve dhe laboratorëve.

Literatura e çdo lënde është treguar në silabuset e çdo lënde, të cilët janë përgatitur nga lektori përkatës i lëndës mësimore. Literatura e përdorur është e huaj, sepse gjuha e mësimdhënies në Universitetin "Epoka" është anglishtja. Provimet përgjithësisht janë mbajtur në formë të shkruar. Megjithatë, pedagogu i lëndës mund të vendosë për të kryer provimin në formën e një provimi me gojë, projekt ose detyrë, me kusht që ai/ajo ta theksojë atë në formën e informacionit për lëndën (planit) brenda dy javëve pas fillimit të lëndës. Provimet janë organizuar dhe kryer nga pedagogët e lëndëve. Studenti mund të bëjë ankesë në lidhje me rezultatin e një provimi përfundimtar brenda një jave nga data e



publikimit të rezultateve, duke paraqitur një ankesë në Sekretarinë Mësimore. Ankesa shqyrtohet më parë nga përgjegjësit e lëndës në lidhje me ndonjë gabim në grumbullimin e pikëve. Këshilli Administrativ i Fakultetit merr vendim lidhur me ankimin e paraqitur në vijim, me propozim të Departamentit, ku subjekti ka paraqitur ankesë. Vlerësimi i studentëve në Universitetin "Epoka" bëhet në bazë të sistemit amerikan të krediteve dhe ECTS-së. Vlerësimi i studentëve bëhet me nota, sipas Tabela 17 në Aneks.

Gjatë takimit me studentet GVJ konstatoi se studentet ishin të kënaqur me kontrollin e njohurive, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e përdorura, si dhe aktivizimin e tyre. (Tabela 20).

GVJ mendon se organizimi i mësimdhënies në forma të ndryshme të saj si leksione, seminare dhe laboratore dhe ndarja e ngarkesës sipas këtyre formave, është bërë në funksion të realizimit cilësor të programit të studimit.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Nga RVB dhe vizita në sekretarinë mësimore rezulton se për pranimin në programin Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike, studentët duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton përfundimin e të paktën një shkolle të mesme si dhe të plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara në rregulloren e Universitetit Epoka. Pranohen për të ndjekur studimet universitare edhe kandidatët që vërtetojnë me dokumente zyrtare transferimin nga një institucion i arsimit të lartë publik ose jo publik. Studentët që regjistrohen për herë të parë, i nënshtrohen procedurës së përzgjedhjes. GVJ ju vunë në dispozicion dokumentacionet nga sekretaria mesimore në lidhje me rregjistrimin dhe ecurinë e studentëve, të rregjistruar për herë të parë dhe të transferuar. Dosjet e studenteve të rregjistruar për herë të parë apo të transferuar rezultuan të sakta dhe të plota, bazuar në rregulloret e pranimit të institucionit. Kriteri i mesatares së shkollës së mesme dhe i provimit të gjuhës angleze u dëshmuar edhe gjatë takimit me studentët. Sipas dokumentacionit të sekretarisë mësimore numri i studentëve në vite si më poshtë: viti I 59 studentë;viti II 59 studentë;viti III 40 studentë.

Gjatë takimit me studentët u evidentua se studentët trajtohen në bazë të rregulloreve të publikuara në faqen e internetit si dhe në Guidat studentore, të cilat u jepen studentëve në formë të printuar në fillim të çdo viti akademik. Studentët informohen edhe nëpërmjet javës së orientimit në fillim të vitit akademik. Studentët vlerësojnë punë e stafit akademik në fund të çdo semestri përmes plotësimit të një ankete. Por studente deklaruan se hasin vështirësi me gjuhën angleze në termat teknik

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve tregohet në Tabela 19 e Aneksit. Nga të dhënat e tabelës rezulton se mesatarja e përgjithshme studentëve në hyrje në 5 vitet e fundit është 9. Të dhënat për cilësinë në dalje janë vetëm për dy vitet e para dhe është 3.21. Nga informacioni i paraqitur në Tabela 20, rezulton se pothuajse të gjithë studentët e diplomuar janë punësuar në përputhje me diplomën.



GVJ mendon Universiteti Epoka informon studentët dhe të interesuarit për procedurat e pranimit të studentëve dhe të kriteret e përcaktura. Në Sekretarinë Mësimore janë të gjitha të dhënat për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim. Cilësia në hyrje e studentëve është e përcaktuar nga kriteri i mesatares (mbi 8) dhe nga njohuritë e gjuhës angleze, edhe pse kishte një ulje të kriterit të mesatares mbi 7 në këtë vit akademik. Universiteti Epoka ndjek një politikë të tërheqjes së studentëve cilësor edhe nëpërmjet aplikimit të bursave.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëprirjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Pranimi i studentëve të rinj në programet e ciklit të parë që ofrohen nga Universiteti "Epoka", bëhet në bazë të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Gjatë përzgjedhjes së kandidatëve aplikohen kriteret e mëposhtme; Kriteret e pranimit për shtetasit e Republikës së Shqipërisë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të kalojë me sukses provimin e pranimit që zhvillohet dhe administrohet nga Universiteti "Epoka"; 2. Të ketë mesatare të Përgjithshme të Shkollës së Mesme mbi 8.00 (viti akademik 2016-2017 mbi 7); 3. Të ketë mbledhur mbi 1400 pikë në Provimin e SAT; 4. Pikët e Provimit të Maturës Shtetërore (pikët minimale bëhen të ditura çdo vit pas publikimit të rezultateve të Provimit të Maturës Shtetërore) <p>Kriteret e pranimit për shtetasit e huaj:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të ketë mbledhur mbi 1400 pikë në Provimin e SAT; 2. Të ketë mesatare të Përgjithshme të Shkollës së Mesme mbi 8.00 ose të barasvlefshme; 3. Të ketë pikë të mjaftueshme nga provimet përzgjedhëse që organizon shteti përkatës për pranim në ciklin e studimeve të barasvlefshëm me ciklin e parë të studimeve të sistemit arsimor universitar të Republikës së Shqipërisë. <p>Univeriteti Epoka ka kritere të veçanta për</p>

	përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. Standarti plotësohet
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>Studentët e Universitetit “Epoka” informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit që ndjekin, mënyrën e organizimit dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet javës së orientimit në fillim të vitit akademik, guidës së studentit, si edhe informacionit të publikuar në faqen zyrtare të Universitetit “Epoka”.</p> <p>Puna e stafit akademik është vlerësuar nga ana e studentëve në fund të çdo semestri përmes plotësimit të një ankete, të përbërë nga kategori të veçanta për vlerësimin e pedagogut, vlerësimin e lëndës, si edhe kënaqësisë së përgjithshme të studentëve për lëndën e dhënë nga pedagogu përkatës.</p> <p>Qendra e Planifikimit të Karrierës (QPK) në Universitetin “Epoka” organizon seminare profesionale në fusha të ndryshme, dhe për të dhënë shërbime këshillimore për studentët që kanë planifikuar të kryejnë praktikë profesionale në periudhën e verës dhe mundëson punësimin e studentëve. Standarti plotësohet</p>
Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Universiteti “Epoka” ka ngritur Zyrën Alumni e cila disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Zyra e Përzgjedhjes dhe Pranimit të Studentëve së bashku me Sekretarinë Mësimore disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.</p> <p>Sekretaria Mësimore disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>
Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën</p>	<p>Universiteti Epoka u ofron këshillim karriere të gjithë studentëve, Qendra për Planifikim të Karrierës, e cila është në varësi të Dekanatit të Studentëve. Qendra e Planifikimit të Karrierës në</p>

profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Universitetin Epoka planifikon seminare, kurse dhe konferenca. Departamenti ka emëruar edhe një këshilltar akademik për çdo vit, i miratuar ky me vendim Senati, me qëllim ndjekjen dhe asistencën për çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor. Departamenti në bashkëpunim me Qendrën për Këshillimin e Karrierës ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit, në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale.
<p><u>Konkluzionet e GVJ</u></p> <p>Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjet në fuqi dhe në bazë të kriterëve të përcaktuara, për të cilat të interesuarit janë të informuar. Këto kriterë përcaktojnë edhe ofrimin e bursave për studentët më të mirë. Gjatë gjithë kohës së studimit studentët trajtohen në bazë të rregulloreve të publikuara në faqen e internetit si dhe në Guidat studentore të cilat u jepen studentëve në formë të printuar në fillim të çdo viti akademik. Studentët informohen edhe nëpërmjet javës së orientimit në fillim të vitit akademik. Puna e stafit akademik vlerësohet nga ana e studentëve në fund të çdo semestri përmes plotësimit të një ankete. Studentëve ju ofrohet këshillim karriere nëpërmjet Qendrës për Këshillimin e Karrierës në bashkëpunim edhe me departamentin. Sekretaria mësimore ka informacion të plotë mbi të dhënat e studentëve, që nga pranimi deri në diplomim.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Sipas RVB, Universiteti Epoka inkurajon stafin akademik në kërkimin shkencor, duke ofruar mbështetje financiare për publikimet e tyre. Sasia maksimale e grantit varion nga tituli akademik që personi përfitues disponon. Në përfundim të çdo viti akademik, të gjitha publikimet shkencore të botuara nga ana e stafit akademik vlerësohen nga një juri e posaçme në bazë të kriterëve të përcaktuara në “Rregulloren për Nxitjen e Publikimeve Shkencore” të Shkollës, duke u mbështetur në kriteret përkatëse. Çdo fundvit, Bordi Administrativ i Universitetit vendos masën e shpërblimit për çdo pikë të fituar dhe në bazë të pikëve të mbledhura, çdo anëtar i stafit akademik përfiton shpërblimin përkatës.

Organizimi ose bashkë organizimi i konferencave dhe i veprimtarive shkencore është një tjetër tregues i punës kërkimore shkencore. Gjatë takimit me stafin akademik dhe Zyrën e Projekteve u evidentua mbështetja financiare për kërkimin shkencor. Të dhënat për aktivitetin shkencor të Stafit të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike janë paraqitur në Aneks, Tabela 21.

GVJ konstaton se Universiteti Epoka bën përpjekje për të motivuar stafin akademik në kërkimin shkencor, duke ofruar mbështetje financiare për publikimet dhe prezantimet e punimeve shkencore.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Mbështetur në RVB dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, Universiteti Epoka ka bashkëpunime me institucione të ndryshme private dhe publike. Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare e cila është nën varësinë e Rektoratit ka si funksion kryesorë zhvillimin dhe zbatimin e politikave ndërkombëtare dhe promovimin i procesit të ndërkombëtarizimit të Universitetit. Në Aneks, Tabela 23 janë paraqitur 30 institucione me të cilat Universiteti Epoka ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi dhe 6 universitete me të cilat është përfshirë në projektin Erasmus +. Të dhënat e paraqitura në Tabela 24 tregojnë se Universiteti Epoka ka aktivitete shkencore të vazhdueshme në kuadër të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Departamenti i Inxhinirisë Kompjuterike ka programe me studentët përse i përket aspektit të kontributit në shoqëri, si Projekti SOFTUP dhe Projekti Code BUDDIES, ky fakt u vu në dukje edhe gjatë takimit me studentët. Gjithashtu u evidentua se mbi bazën e bashkëpunimeve me institucione dhe kompani të ndryshme, mundësohet realizimi i praktikave të studentëve brenda dhe jashtë vendit, kryesisht gjatë sezonit të verës.

GVJ konstatoi se pavarësisht numrit të madh të bashkëpunimeve nuk ka një analizë të përfitimeve direkte nga marrëveshjet të bashkëpunimit për programin Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike. Rekomandohet të hartohen raporte analitike në lidhje me bashkëpunimet.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbyllja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme</p>	<p>Universiteti Epoka nxit frymën e bashkëpunimit ndërmjet stafit të universitetit duke i nxitur ata që të bëhen pjesë e projekteve të ndryshme ose të bëjnë kërkime shkencore në bashkëpunim me njëri tjetrin.</p> <p>Kompetencat dhe ndarja e detyrave të personeli është i parashikuar në Rregulloren e Organizimit</p>

bashkëpunimi.	Administrativ, e cila mundëson marrjen e përgjegjësive përkatëse dhe analizën e vazhdueshme të punës së tyre dhe garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.
---------------	---

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Universiteti Epoka në bashkëpunim me njësitë e veta funksionale ndjek një strategji të hapur për bashkëpunim dhe partneritet në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për realizimin e misionit dhe të qëllimit të tij.</p> <p>Universiteti Epoka ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e huaja arsimore.</p> <p>Universiteti Epoka u kushton rëndësi praktikave profesionale. Prandaj, gjatë verës studentët nxiten dhe iu ofrohet mundësia të ndjekin praktika mësimore në formë stazhi. Universiteti Epoka ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë.</p> <p>Gjatë vitit akademik 2015-16, 23 studentë kanë kryer stazhin veror ku vetëm gjashtë janë kryer me ndermjetesimin e universitetit.</p> <p>Universiteti Epoka organizon trajnime, disa prej këtyre programeve janë: Trajnimi i stafit të Universiteti Epoka për vendosjen e standarteve ISO; Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë; Komunikimi i brendshëm institucional etj.</p>
---	---

Konkluzionet e GVJ:

Universiteti Epoka, për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet dhe kompani të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Marrëveshjet janë në nivel institucioni, nuk mund ti ndajmë ato që kanë lidhje direkte me këtë program studimi.

Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ka organizuar aktivitete me studentët sic janë projektet SOFTUP ose Code BUDDIES për të pasur një kontribut direkt për publikun.

GVJ konstatoi se pavarësisht numrit të madh të bashkëpunimeve, nuk ka një analizë të përfitimeve direkte nga marrëveshjet të bashkëpunimit për programin Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike. Rekomandohet të hartohen raporte analitike në lidhje me bashkëpunimet.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

Plotësimi i tyre nga Universiteti EPOKA:

- a) Mendoj se Institucioni ka plotësuar rekomandimin a) të Këshillit të Akreditimit
- b) Mendoj se Institucioni ka plotësuar rekomandimin b) të Këshillit të Akreditimit
- c) Mendoj se Institucioni ka plotësuar rekomandimin c) të Këshillit të Akreditimit
- d) Mendoj se Institucioni ka plotësuar rekomandimin d) të Këshillit të Akreditimit
- e) Mendoj se Institucioni ka plotësuar rekomandimin e) të Këshillit të Akreditimit

Mendoj se Institucioni ka plotësuar të gjitha rekomandimet e Këshillit të Akreditimit.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS - PIKAT E FORTA, WEAKNESSES - PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES - MUNDËSITË, THREATS - PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Universiteti Epoka është i konsoliduar nga ana organizative dhe funksionale.
- 2) Programi i studimit është në përputhje me misionin dhe objektivat strategjike të zhvillimit të institucionit.
- 3) Departamenti ka personel akademik efektiv dhe me kontratë për të mbuluar ngarkesën mësimore të programit të studimit.
- 4) Departamenti ka staf akademik të diplomuar jashtë vendit
- 5) Universiteti Epoka realizon rregullisht vlerësimin e performances së stafit akademik;
- 6) Infrastruktura e Universitetit në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor
- 7) Universiteti Epoka realizon një proces të përzgjedhjes për regjistrimin e studentëve.
- 8) Universiteti Epoka ofron bursa të pjesshme dhe të plota për të tërhequr studentët e mirë
- 9) Në Universitetin Epoka studentët organizohen në projekte studentore.

b. Pika të dobëta:

- 1) Ngarkesa mësimore javore e lartë e stafit akademik efektiv.
- 2) Niveli ulët i njohurisë së gjuhës angleze nga ana e një pjese të studentëve



- 3) Në syllabuset e lëndëve nuk janë paraqitur njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për ndjekjen e lëndës.
- 4) Pjesëmarrja e ulët në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare
- 5) Mungesa e mobiliteteve të studentëve si edhe mungesa e programeve të përbashkëta.

c. Mundësitë:

- 1) Mundësi për punësimin e studentëve, për shkak të kërkesave të vazhdueshme të tregut të punës.
- 2) Mundësi për implementimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit duke rritur mobilitetet e stafit dhe studentëve. Zhvillimi i mësimin në gjuhën Angleze rrit mundësinë për mobilitetet e studentëve nga universitetet jashtë Shqipërisë drejt këtij Universiteti.
- 3) Mundësi për përmirësimin e ngarkesës mësimore javore të stafit akademik efektiv
- 4) Mundësi për të rritur pjesëmarrjen në projekte kërkimore shkencore

d. Pengesat:

- 1) Rënie të numrit të përgjithshëm të studentëve në vitet e ardhshme;
- 2) Vështirësi në punësimin e stafit akademik me tituj e grada, si dhe stafit akademik të kualifikuar të huaj;
- 3) Vështirësi për të marrë pjesë në projekte.

SWOT ANALYSIS

a. Strengths:

- 1) The Epoka University is organically and functionally consolidated.
- 2) The study program Bsc.In Computer Engineering is in line with the mission and strategic objectives of institution development.
- 3) The Department has effective and contracted academic staff to cover the teaching load of the study program.
- 4) The academic staff of the department is graduated abroad
- 5) The Epoka University evaluates regularly the performance of academic staff.
- 6) The infrastructure of the university available for teaching and research process
- 7) The Epoka University has a selection process for student enrollment.
- 8) The Epoka University offers partial and full scholarships to attract good students
- 9) The students are organized in the extracurricular projects

b. Weaknesses

- 1) The weekly teaching load of effective academic staff is high.
- 2) The level of knowledge of English by a part of students
- 3) The syllabuses do not give the preliminary knowledge that the student must have for the subject acquisition
- 4) The low level of participation in various national and international projects
- 5) The lack of student mobility as well as joint programs;

c. Opportunities

- 1) Opportunities for the student employment due to continued labor market demands.
- 2) Opportunities to implement cooperation agreements by increasing staff and student mobility. Teaching in English language is a good opportunity for the mobility of students from non-Albanian universities to this University.
- 3) Opportunities to improve the weekly teaching load of effective academic staff
- 4) Opportunities to participate in scientific research projects



d. Threats:

- 1) Decreasing the number of students in the next years
- 2) Difficulties in recruiting effective academic staff with titles or degrees as well as in recruiting foreign qualified academic staff
- 3) Difficulties in participating in projects

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Elinda Kajo Meçe

